

VENDIM
Nr. 872, datë 30.10.2015

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2016, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

(Ndryshuar me VKM nr.604, datë 31.8.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2016, në shumën *43 756 000 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë*, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	në lekë
1	Shpenzime për paga	25 577 000
2	Sigurime shoqërore	3 914 000
3	Shërbime e furnitura	13 000 000
4	Investime	1 265 000
	TOTALI	43 756 000